

VENDIM
Nr. 27, datë 5.5.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR VEPRIMET ME
FONDET NË VLERA MONETARE NË BANKËN E SHQIPËRISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, të nenit 43, shkronja “c” dhe të kreut V, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për veprimet me fondet në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 56, datë 6.8.2015, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 4, pika 1, shkronja “j”, ndryshon përmbajtje si vijon:

““koli” – është ambalazhi i mbyllur me shirit të numërtuar ose i plumbosur me vulë të dallueshme i tillë si: arka, thesi, kutia, qesja, pakoja e kartonit, ku vendosen kartëmonedha ose monedha metalike. Në rastin e kolive në formën e arkave ose pakove të kartonit të ardhura nga prodhimi, mbyllja është realizuar me dy shirita plastikë të vendosur paralel/kryq me njëra tjetrën”;

b) në nenin 15, pika 2, shkronja “a”, shprehja “përgatiten dhe paketojnë” zëvendësohet me shprehjen “të përbëra nga koli në formën e arkave të ardhura dhe paketuara nga prodhimi dhe/ose nga koli të përgatitura në qendrat e *cash*-it të paketuara”;

c) në nenin 15, pika 2, shkronja “b”, pas shprehjes “dërgesa me monedha metalike” shtohet shprehja “të përbëra nga koli në formën e pakove të kartonit të ardhura nga prodhimi dhe/ose nga koli të përgatitura në qendrat e *cash*-it, të paketuara si më poshtë”.

2. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko